

VENDIM
Nr.805, datë 6.10.2010

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.591, DATË 23.7.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR DISIPLINIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE BUXHETORE”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të shkronjës “ç” të pikës 3 të kreut I të vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të shkronjës “dh” të pikës 1 të vendimit nr.591, datë 23.7.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohen paragrafët, me këtë përmbajtje:

“Përfundimisht, lejohet Ministria e Shëndetësisë, Drejtoria e Shëndetit Publik, Korçë, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit për objektin “Rikonstruksion dhe shtesë kati për ndërtesën e klinikës dentare”.

Përfundimisht, lejohet Ministria e Shëndetësisë, Drejtoria e Spitalit, Korçë, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit për objektin “Ndërtimi i sistemit të ngrohjes dhe ujit sanitar për spitalin e Korçës”.

Përfundimisht, lejohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet e saj të varësisë, si autoritete kontraktore, të vijojnë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit dhe lidhjen e kontratave për projektet dhe shërbimet, si më poshtë vijon:

i) Për blerjen e pajisjeve elektronike të laboratorëve të informatikës për arsimin e mesëm profesional, me fondet e miratuara me vendimin nr.748, datë 15.9.2010 të Këshillit të Ministrave.

ii) Për blerjen e librave artistikë për krijimin e fondit të bibliotekave për vitin shkollor 2010, në të gjitha drejtoritë rajonale arsimore dhe zyrat arsimore në rrethe.

iii) Për blerjen e mallrave, shërbimeve, rikonstruksioneve dhe ndërtimit të objekteve në institucionet e arsimit të lartë, të cilat kanë si burim financimi fonde nga të ardhurat dytësore apo donatorët.

iv) Për blerjen e mallrave, shërbimeve, rikonstruksioneve dhe ndërtimit të objekteve në institucionet e sistemit të arsimit dhe njësitë e pushtetit vendor, të cilat kanë si burim financimi, fonde në kuadër të projektit “Cilësi dhe barazi në arsim.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha